

CHILD-DIRECTED LANGUAGE BY YOUNG PEOPLE OR “BABY TALK”

PËRDORIMI I GJUHËS FËMIJËRORE NGA TË RINJTË OSE “BABY TALK”

Albulena DEHARI¹, Lindita SKENDERI²

¹ Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

² Department of English Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

*Corresponding author e-mail: albulena.zulbeari@unite.edu.mk & lindita.skenderi@unite.edu.mk

Abstract

The purpose of this paper is to see the way young people communicate and how they speak to each other, in this topic we are first discussing the genesis of when the process of childish speech begins which on the beginning relies mainly in their mother tongue and then stems from imitating the language of other family members and the relative social environment. This talk has been a major influence for young people by being adopted by the female gender and becoming part of their vocabulary.

The methods we have used for this paper are descriptive and experimental methods, that we not only used them separately, but also in conjunction with each other, we used the experimental method by doing a survey in which we asked some questions regarding the communication that young people use with each other, when they are in a school environment and when they are in a social environment, we conducted this survey for the youth of the Tetovo High School of Economics and the students of the Faculty of Philology, Albanian language and literature and the department of English language.

Key words: *Language, communication, Baby talk, youth, usage.*

Përmbledhje

Qëllimi i këtij punimi është që të shohim mënyrën e komunikimit të të rinjve se si flasin ata mes veti, në këtë temë po shtjellojmë në fillim zanafillën se kur fillon procesi i së folurës fëmijërore i cili mbështetet kryesisht në fillim tek gjuha e nënës së tyre e cila më pas rrjedh me imitimin e gjuhës së anëtarëve të tjerë të familjes dhe mjedisit të afërm shoqëror. Kjo e folur ka qenë një ndikim i madh për të rinjtë duke u përvetësuar nga gjinia femërore dhe duke u bërë pjesë e fjalorit të tyre.

Metodat të cilat i kemi përdorur për këtë punim janë metoda deskriptive dhe eksperimentale të cilat jo vetëm që i përdorëm veç e veç, por edhe të bashkuara njëra me tjetrën, metodën eksperimentale e kemi realizuar duke bërë një anketë në të cilën kemi parashtruar disa pyetje në lidhje me komunikimin që përdorin të rinjtë mes veti, kur janë në mjedisin shkollor dhe kur janë në mjedise shoqërore, këtë anketë ua kemi bërë të rinjve të shkollës së mesme ekonomike të Tetovës dhe studentëve të Fakultetit Filologjik, drejtimi gjuhë shqipe dhe letërsi dhe studentëve të katedrës së gjuhës angleze.

Fjalët kyçe: *Gjuha, komunikimi, “Baby talk”, të rinj, përdorimi.*

Hyrje

Nxjerrja në dritë e parimeve të përgjithshme të strukturës së gjuhës fëmijërore kërkon zhvillime të përpikta rreth zbatimit të kësaj gjuhe. Rreth kësaj strukture gjuhësore janë marrë studiues të ndryshëm po përmendi këtu, Oskar Blokut i cili njihet edhe si specialistë i kësaj gjuhe dhe që ka bërë kërkime të shumta lidhur me gjuhën fëmijërore, gjithashtu me këtë problematik është marrë edhe gjuhëtari belg Antuan Greguar në veprën e tij “Të nxënit e të folurit”. Ndërkaq R. Jakobsoni thotë se fillimi i vërtetë i të folurit të fëmijës paraprihet nga një fazë përgatitore që quhet periudha e babelit.¹⁸

Në këtë periudhë kohore të fëmija dallohen sasi tingujsh të paidentifikuar, si bashkëtingëllore, zanore, grupe zanore, grupe bashkëtingëlloresh etj., përmes kësaj ai mundohet të akordojë telat e zërit duke u munduar të imitoj zërat që i dëgjon përreth. Gjatë kësaj periudhe fëmijët mundohen të krijojnë të gjithë tingujt e imagjinuar, por pa përmbajtje. Siç thotë, Byleri: fëmijët tanë në fillim nuk artikulojnë as gjermanisht, as kaukazisht.¹⁹ Me rritjen e fëmijës është e kuptueshme që ai fillon të artikulojë fjalë e shprehje të cilat shpesh i thotë gjysmake e shpesh nuk artikulojnë tinguj e shkronja të caktuara e me këtë ai fjalën nuk e shprehën siç duhet.

Me rritjen e tij, ai nuk është vetëm, por me të jetojnë edhe anëtarët e tjerë të familjes nga dashuria për fëmijën e vogël, nga dashuria për t’iu përshtatur atij ata mundohen t’i imitojnë fjalët e tij. Por ky fenomen nuk mbaron me kaq pasi kjo gjuhë është mjaft e shprehur edhe ndër të rinjtë sidomos gjinia femërore e kanë pjesë të pandashme të fjalorit të tyre. Në këtë punim kemi përfshirë një anketë që ua kemi bërë të rinjve në qytetin e Tetovës lidhur me përdorimin e gjuhës fëmijërore. Përmes kësaj ne shohim më qartë gjuhën, se cilat shprehje janë më shumë të përdorura dhe në çfarë konteksti i përdorin ato shprehje. Në këtë punim jemi munduar të japim prejardhjen e të folurës së fëmijëve, si ka filluar ajo, nga kush ka filluar dhe për të mbërritur deri në ditët e sotme ku kjo gjuhë bëhet pjesë e sistemit gjuhësor, duke u përdorur në masë të madhe nga rinia.

Prejardhja e të folurit të fëmijëve nga të rriturit ose “Baby – talk”

Interesi për gjuhën që fëmijët përdorin nuk është mjaft i ri, ajo ka një traditë shumë të gjatë, por deri shumë vonë nuk ka pasur mjaftueshëm studime rreth kësaj gjuhe. Zakonisht kjo gjuhë përdorej nga nënat dhe quhej edhe si motherese²⁰, kur ata ushqenin fëmijët apo edhe për t’i mashtruar për ndonjë gjë gjithmonë flisnin në gjuhën e tyre me këtë që të hynin edhe në botën e tyre. Me kalimin e kohës kjo gjuhë ka filluar të flitet edhe mes vetë të rriturve.

Kërkimet e mëtejme kanë bërë të mundur që të ndërhyjnë modifikime semantike do t’i shohim se cilët janë ato modifikime sipas Gj. Shkurtajt.

- a) Mënyra e prodhimit: baby- talk është më i ngadalshëm, në përgjithësi më i rrjedhshëm, dhe i shqiptuar më shkoqur se sa të folurit e tjerë;
- b) Thjeshtësia formale: frazat që u drejtohen të vegjëleve janë më të shkurta dhe më të thjeshta nga ndërtimi sintaksor;
- c) Aspekti prozodik: ka një numër të madh të toneve të zërit, sidomos kur flasin me zë të lartë;
- d) Thjeshtësia semantike dhe tepria e fjalëve (ridondance): frazat e baby – talk-ut kanë një fjalor të kufizuar dhe më të ngushtë, kanë më shumë përsëritje dhe argumentet e temat janë më të

¹⁸ Gjovalin Shkurtajt, *Sociolinguistikë e shqipes-Nga dialektologjia te etnografia e të folurit*, Morava, Tiranë, 2009.

¹⁹ Po aty.

²⁰ Gjovalin Shkurtajt, *Sociolinguistikë e shqipes -Nga dialektologjia te etnografia e të folurit*, Morava, Tiranë, 2009, f. 94.

kufizuara, kryesisht u referohen gjërave konkrete e që janë të pranishme në mjedis ose u përkasin ngjarjeve ku janë të përfshirë si fëmijët ashtu edhe të rriturit.²¹

Çështje shumë e rëndësishme është se a po mësojnë fëmijët më shpejt të flasin kur prindërit e tyre apo anëtarët e tjerë të familjes shprehin me gjuhën e tyre, por nuk ka ndonjë studim të tillë i cili ka mundur që të vë në pah se fëmijët mësojnë të flasin më shpejt, por ata që kanë më shumë komunikim me prindërit apo anëtarët e tjerë të rrethit, kur do të rriten do kenë më shumë lehtësi në formimin e frazave më të gjata, ende nuk ka një punim që e vërteton këtë, kjo gjuhë përdoret më shumë nga prindërit që ta ndiejnë më afër gjendjen e fëmijës së tyre. Kjo gjuhë, pra zanafillën e ka nga nënat, lirisht mund të themi se nëna fillon të bisedoj me fëmijën edhe kur është shtatëzanë, ajo i drejtohet të voglit të saj si *spilti mamit*, *xemla mamit* dhe e gjitha kjo për t'u futur në botën e fëmijës.

Kjo e folur më pas pasohet nga gjyshërit të cilët i kanë rritur fëmijët dhe sot ka marrë përmasa shumë të gjera e përdoret në mbarë shoqërinë, sidomos tek të rinjtë. Përmes këtij komunikimi fëmijët fillojnë të imitojnë së pari prindërit e tyre në të folur, pastaj gjyshërit, shokët dhe njerëzit e mjedisit ku ai po rritet, përmes kësaj fëmija pra nuk e mëson gjuhën si tërësi rregullash apo si një kod abstrakt, por ai e mëson gjuhën e atij mjedisi të vogël ku ai po zhvillohet. Për të kryer këtë studim se sa flitet gjuha e fëmijëve nga të rriturit ne kemi kryer një anketë me nxënësit e disa shkollave të mesme dhe me studentët. Rezultatet e kësaj ankete po i paraqesim në vijim.

Baby – talk

Në vijim po paraqesim një anketë të cilën e kemi realizuar me studentët e Universitetit të Tetovës, kryesisht studentët e fakultetit filologjik të drejtimit të gjuhës shqipe dhe letërsisë dhe të gjuhës angleze dhe me nxënësit e shkollës së mesme të shkollës Ekonomike. Përgjigjet e tyre i kemi analizuar dhe kemi nxjerrë këto rezultate të cilat do t'i paraqesim më poshtë.

Tek të rinjë përdoren shumë zbunimet ku ata flasin me përkëdhelje me njëri-tjetrin, në këtë bënë pjesë edhe kjo dukuri, relativisht e cila është e përhapur midis tyre dhe që quhet “Baby Talk” (shqip. gjuhë fëmijërore), ku qëllimi i përdorimit të kësaj gjuhe mes të rinjve nuk është më se i drejtohen fëmijëve të vegjël apo komunikojnë me ta, por është të shprehurit më me përkëdheli mes njëri-tjetrit për të treguar dashurinë dhe afërmitetin që kanë mes veti.

“Baby Talk” përdoret më shumë nga vajzat, rreth 60% e tyre përdorin gjuhën e fëmijëve në komunikimet intime ose personale më njëra-tjetrën. Por nga ajo që kemi vërejtur ky komunikim më shumë është i përdorur nga nxënësit e shkollës së mesme të cilët i kemi anketuar krahas studentëve. Të rinjtë e shkollës së mesme, sidomos vajzat u shprehën se përmes këtij komunikimi ndjehen më afër shoqës së tyre apo e shprehin dashurinë që kanë për shoqen, kurse studentët janë shprehur se nuk janë të apasionuar pas këtij komunikimi pasi u duket i neveritshëm dhe jo shumë i mirë, por edhe aty kemi një për qindje shumë të vogël që e përdorin, por vetëm në raporte shumë të afërta shoqërore.

Të rinjtë u shprehën se këtë gjuhë e përdorin për arsyeje të ndryshme, si p.sh., për:

□ Për zbunim, duke krijuar kështu forma të ndryshme të emrave të shoqeve të tyre si p.sh: *Mila për Emira, Lila për Lirije, Diki për Shadije, Lola për Aurora, Mona për Edmonda, Lili për Liridona, Tinka për Artina, Nina për Elmedina, Nina për Elvira, Nesa për Qëndresa, Lule për Lumturiye* etj.

□ Për të krijuar e treguar më shumë afri me njëra-tjetrën. Ky lloj të foluri shprehet në dy forma: e para kur e shkurtojmë emrin ashtu si fëmijët e shqiptojnë, dhe e dyta është kur fjalët i shqiptojmë ashtu si i thonë fëmijët. Shembuj të ndryshëm të këtyre dy kategorive janë:

²¹ Gjovalin Shkurta, *Sociolinguistikë e shqipes-Nga dialektologjia te etnografia e të folurit*, Morava, Tiranë, 2009, f. 94, 95.

o Fjalë, si: *xemlushe, xhemla, xemël për zemër, pilti, spilti, piltush për shpirti, pshe për pse, mosh për mos, zhdu për s'dua, sko për shko, skala për shkallët, xhogi për zogun, xhalmi për zjarrin, letla për letrën, motla për motrën, moki për smoki (lloj patatinash), neshër për nesër* etj.

o Shprehje, si p.sh., *o xhot ça i mil* (o Zot sa i mire) *s'më pëcen* për nuk më pëlqen; *tha thua* për çfarë thua; *Ça i milëë jee* është e folura femënore që në gjuhën e të rriturve “përkthehet”: Sa i mirë je!; *Ku kove* për Ku shkove?, *dasulie mamit* (dashuria e mamit), *piti mamit* (shpirti i mamit) etj.

Nga anketat e realizuara, nga 280 femra që kemi anketuar, 187 janë përgjigjur se i përdorin shumë këto shprehje, kurse 93 që nuk i përdorin aq shumë, kurse djemtë janë përgjigjur se nuk e përdorin fare këtë gjuhë dhe shpesh ju ngjall neveri kur dëgjojnë vajzat duke folur në atë formë. Grafikisht kjo do të dukej kështu:




Fig. 1. Përdorimi i baby talk.

Përfundimi

Në fillim fëmija e mëson gjuhën nga gjetha që e merr nga nëna e tij qëkur është i vogël, pra nga momenti që fillon të dëgjoj. Ai mëson të flasë ashtu siç e dëgjon nga rrethi familjarë dhe mikromjedisi që e ka kur është i vogël. Ai mundohet t'i imitoj format gjuhësore që i dëgjon nga ata. Shumë e rëndësishme është rrethi familjarë dhe ai farefisnor në mësimin e komunikimit të fëmijëve, pasi nëse aty flitet pastër nuk përdoren fjalë të këqija edhe fëmija do të edukohet të flasë në atë formë, duhet pasur shumë kujdes pra se në çfarë gjuhe flasim në prani të fëmijëve.

Nga ajo forma e komunikimit që kanë fëmijët ka pasur shumë ndikim edhe tek të rinjtë të cilët e kanë përvetësuar këtë gjuhë dhe e përdorin në mes veti për të shprehur afërsinë dhe dashurinë që kanë. Vajzat e reja janë më të dhëna pas kësaj gjuhe dhe e përdorin në masë të madhe kur duan të flasin me përkëdheli dhe siç e kemi dëgjuar nga djemtë ata edhe kur llastohen flasin më shumë në atë formë. Kjo mënyrë e të folurit duhet studiuar edhe më shumë, pasi po bëhet një zhargon në veti dhe po identifikon një brez shoqëror.

Referencat

- [1]. Beci, B., *Gjuha letrare shqipe dhe bazat e saj dialektore*, Tiranë, 1995.
- [2]. Shkurtaj, Gj., *Sociolinguistikë e shqipes-Nga dialektologjia te etnografia e të folurit*, Shtëpia botuese Morava, Tiranë, 2009.
- [3]. Shkurtaj, Gj., *Sociolinguistika*, Tiranë, 2005.
- [4]. Shkurtaj, Gj., *Në gjurmët e zhargonit studentor*, Tiranë, 2004.
- [5]. Thomai, J., *Lëvizje në leksikun e gjuhës shqipe në kushtet e reja historiko-sociale*, Shkup, nr. 6, 2000.
- [6]. Thomai, J. *Teksti dhe gjuha*, SHBLU, Tiranë, 1992.